



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

MINISTRI

Nr. 2637 Prot.

Tiranë, më 08.03. 2018

UDHËZIM

NR. 13, DATË 08.03. 2018

PËR

ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË,
VITI SHKOLLOR 2017-2018

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 50 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, dt. 10.12.2010 “Për krijimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 26.4.2017, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 67, dt. 10.02.2013 “Për krijimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 352, dt. 03.04.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit”,

UDHËZOJ:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë, për vitin shkollor 2017-2018, do të zhvillohen si më poshtë:
 - a) Lënda Gjuhë e huaj, më 11 qershor 2018.
 - b) Lënda Gjuhë shqipe, më 18 qershor 2018.
 - c) Lënda Matematikë, më 22 qershor 2018
2. Nxënësit e pakicave kombëtare zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë në lëndën **Gjuhë amtare**. Provimi kombëtar i arsimit bazë në lëndën Gjuhë amtare, do të zhvillohet më **15 qershor 2018**.
3. Lista e gjuhëve të huaja, që do të jepen si provim i detyruar janë: anglisht, italisht, frëngjisht dhe gjermanisht. Testi i gjuhës/ve të huaj/a hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët, trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.

4. Nxënësit e klasave të IX-ta parapërgatitore për seksionet dygjuhëshe italiane, gjermane dhe franceze janë të lirë të zgjedhin midis gjuhës së huaj të parë që kanë filluar në klasën e III-të dhe gjuhës së huaj të seksionit përkatës të filluar në klasën e VI-të.
5. Testi i gjuhës së huaj për nxënësit e klasave të IX-ta parapërgatitore për seksionet dygjuhëshe italiane, gjermane dhe franceze të hartohet dhe të korrigjohet në bashkëpunim me mësuesit e huaj dhe shqiptarë të këtyre seksioneve.
6. Provimet kombëtare të arsimit bazë, fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.
7. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në Rregulloren për “Procedurat e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2017- 2018”.
8. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, teza për provimin në lëndën Gjuhë amtare, përgatitet nga DAR Gjirokastër. Në ditën e provimit, Zyra Arsimore Delvinë dhe Zyra Arsimore Sarandë, tërheqin tezën në DAR Gjirokastër.
9. Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase, teza për provimin në lëndën Gjuhë amtare, përgatitet nga DAR Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i DAR Korçë.
10. Nxënësit me aftësi të kufizuara zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre.
11. Për institutin e nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi”, drejtorja e institutit tërheq testin nga QShA-ja, një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit brail.
12. Nxënësi mbetet në provimet kombëtare të arsimit bazë, ka të drejtën e riprovimit në sesionin e dytë.
13. Inspektorati Shtetëror i Arsimit monitoron procesin e provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur në zhvillimin e tyre.
14. Arkivimi i testeve të bëhet pranë DAR/ZA-ve, në Qendrat e Vlerësimit të Testeve.
15. Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës i DAR/ZA-së merr nga Qendrat e Vlerësimit të Testeve dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet kombëtare të arsimit bazë. Këto të dhëna dërgohen në QShA, ISHA dhe MASR.

16. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Drejtoritë Arsimore Rajonale, Zyrat Arsimore dhe institucionet shkollore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

~~MINISTËR~~

Lindita Nikolla

